

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Tiranë për projektin “Rikonstruksioni i rrugëve lokale dhe sekondare të Tiranës” me objekt “Mbi zbatimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe vlerësimi i projektit” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2014 deri me datë 31.08.2015, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.176, datë 29.12.2015

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 802/6, datë 29.12.2015, dërguar z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi:

Projekti “Rikonstruksioni i rrugëve lokale dhe sekondare të Tiranës”, është kredi në shumën 14,600,000 euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me qëllim ndihmesën në rehabilitimin dhe zhvillimin e rrugëve në bashkinë e Tiranës. Ky projekt është audituar për 5 komponentë të tij deri në muajin dhjetor të vitit 2013.

-Rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm janë realizuar rreth 76 %, prej tyre.

Nga 21(njëzetënjë) masa organizative të rekomanduara janë realizuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa, 2(dy) masa është janë realizuar pjesërisht dhe 3(tre) masa nuk janë realizuar.

Nga 4 (katër) masa të rekomanduara për shpërblim dëmi janë realizuar 3 (tre) prej tyre. Nuk është ndjekur në rrugë ligjore kërkesa për shpërblim dëmi prej 207,600 lekë, për shpenzime të pa justifikuara karburanti.

Nga 4(katër) masat disiplinore, të rekomanduara janë realizuar 3 (tre) masa dhe 1 (një) masë nuk është realizuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 12-19, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të marrin masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, si edhe të ndjekin në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit me vlerë 207,600 lekë, për shpenzimet e pajustificuara të karburantit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:

Referuar Marrëveshjes për shumën e huas, Bashkia e Tiranës, duhet të shlyejë interesat e huas sipas një normë të ndryshueshme interesi. Pagesat e interesit do të bëhen çdo 6 qershor dhe 6 dhjetor të çdo viti. Norma e Tarifës së Angazhimit 0.5% për vit.

Bashkia e Tiranës ka paguar pjesërisht detyrimet e kredisë, por jo sipas afateve të parashikuara. Ajo ka paguar interesat e dy ose tre periudhave bashkë dhe gjithashtu ka pa paguar interesat që nga 6-mujori i dytë i vitit 2012 deri në 6 mujorin e I të vitit 2015, pra konstatohet se për 3 vjet nuk ka paguar normën e tarifës së angazhimit, në kundërshtim me nenin 5, pika 5.01 dhe 5.02 të Marrëveshjes së Nën-huas, datë 04.09.2006, ku citohet se Bashkia e Tiranës merr përsipër të shlyej interesat e huas dhe normën e tarifës së angazhimit çdo datë 6 qershor dhe 6 dhjetor të çdo viti (*trajtuar më hollësisht në faqen 20 të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të marrin masa për shlyerjen e detyrimeve sipas afateve të përcaktuara në Marrëveshjet e Nën huas për të siguruar nivelin dhe ritmin e programuar të disbursimeve në funksion jo vetëm të realizimit në afat të projektit, por edhe për të shmangur kostot subjektive nga pagesa e tarifës së angazhimit.

Në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi NJZP përbëhet nga 7-8 punonjës, strukturë e cila ka pësuar ndryshime të vazhdueshme të punonjësve ku konstatohen lëvizje të shpeshta të punonjësve, kryesisht financiarëve të projektit, deri në 4 financiarë/vit, ndryshime që nuk kanë plotësuar një nga kriteret e përcaktuara në marrëveshje për plotësimin e strukturës së NJZP me personel të kualifikuar, duke sjellë risk të shtuar operacional. Punonjësit e larguar nuk kanë bërë dorëzimin e dokumentacionit dhe të detyrës me procesverbal nga punonjësit pasardhës, veprime që kanë sjellë vështirësi në auditim për vënien në dispozicion të dokumentacionit, rakordimin e shumave dhe veprimeve të kryera për projektin nga fillimi i tij deri në periudhën e auditimit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.171, datë 26.03.2014 Kreu VII “Lirimi nga Shërbimi civil”, dorëzimi i detyrës, pikat 49-52(*trajtuar më hollësisht në faqet 29- 33, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë dhe NJZP, të marrë masat e nevojshme për plotësimin strukturës organizative të projektit me punonjës të kualifikuar dhe të eliminohen lëvizjet e shpeshta të personelit.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi:

Referuar ndryshimeve në vite të strukturës së NJZP dhe volumit të punës, konstatohet se rregullorja e brendshme, në fuqi prej vitit 2012, nuk iu përgjigjet kërkesave dhe detyrave të përcaktuara sipas strukturës organizative të NJZP, si dhe nuk janë përcaktuar detyrat e punonjësve të njësisë (*trajtuar më hollësisht në faqen 38, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të hartojnë rregulloren e brendshme të funksionimit duke përcaktuar detyrat për çdo pozicion pune, me qëllim azhurnimin e saj sipas kërkesave dhe strukturës organizative të miratuar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Nga drejtuesit e NJZP, nuk janë përcaktuar rregulla dhe procedura të qarta dhe nuk janë miratuar përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve, nuk ka ndarje të funksioneve për stafin, në përputhje me ligjin nr 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 9, përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherit të njësisë publike (*trajtuar më hollësisht në faqen 38, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve të përcaktojë rregulla dhe procedura të qarta për menaxhimin e aktiveve, si dhe ndarje të funksioneve për stafin në përputhje me ligjin nr 10296, datë 8.01.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi:

Projekti në zbatimin e objektit të fundit është mbi 7 vjet jashtë afatit të vlefshmërisë së përdorimit të huas, i kërkuar dhe ndryshuar për deri në muajin mars të vitit 2016, nga viti 2008 që ishte parashikuar në Marrëveshje. Niveli dhe ritmet e disbursimeve kanë qenë të ulëta, duke bërë edhe shtyrje të afatit të disbursimeve disa herë (*trajtuar më hollësisht në faqet 23- 25, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë dhe NJZP të marrë masat e nevojshme për përfundimin në afatet e parashikuara në marrëveshje të projekteve me financime të huaja, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm nga Njësia e Zbatimit të Projektit, me qëllim për të shmangur rritjen e kostove financiare, si dhe sigurimin e maksimumit të përfitimeve.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi:

Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka hapur “Llogarinë rezervë të shërbimeve debitore, duke mos evidentuar të ardhurat dytësore të saj, si dhe duke hequr mundësinë që banka të ketë akses të drejtpërdrejtë në çdo kohë për të gjithë regjistrat dhe deklaratat në lidhje me këtë llogari (*trajtuar më hollësisht në faqen 23, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve t’i përmbahet me rigorozitet raportimeve, hapjes së llogarive krahas asaj kryesore, si dhe afateve të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, për të pasur ecuri normale të zbatimit të tyre.

Në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi:

NJZP për vitin 2013, nuk i ka siguruar bankës raportin e auditimit për pasqyrat financiare nga auditues të pavarur jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të vitit fiskal; në kundërshtim me nenin III, pika 3.01, shkronja (b) 2, të Marrëveshjes së Projektit midis bashkisë Tiranë dhe BERZH të datës 15.06.2006.

Për vitin fiskal 2014, raporti i auditimit nuk është hartuar deri në momentin e përfundimit të auditimit datë 13.11.2015. Raportet e auditimit nuk janë dorëzuar referuar afatit të parashikuar në nenin 3 pika 3.01 (b) të Marrëveshjes së Projektit datë 30.06.2006, si edhe raporti i auditimit të pasqyrave financiare i vitit 2014, nuk është bërë ende (*trajtuar më hollësisht në faqen 23, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve, të marrë masa për të siguruar në afatet kohore të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit, raportet e auditimit të pasqyrave financiare për projektet në vazhdim.

Në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi:

NJZP, nuk ka kryer inventarizimin fizik të aktiveve, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” Inventarizimi i aktiveve, pikat 73,74, etj(*trajtuar më hollësisht në faqen 29-30, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të marrin masa për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve, me qëllim pasqyrimin e saktë të tyre sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi:

NJZP, ka detyrime të papaguara për TVSH e likuiduar nga kontraktori në shumën 12,549,565 lekë, sepse Bashkia e Tiranës nuk ka akorduar fondet për projektin(*trajtuar më hollësisht në faqen 28, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrin masa e nevojshme për uljen e detyrimeve për pagesat e tvsh-së ndaj kontraktorit në shumën 12,549,565 lekë. Për projekte të ngjashme të sigurojnë paraprakisht në buxhet, burimet e nevojshme për sigurimin e çdo pagese të lidhur me tvsh.

Deri më 30.06.2016

11.Gjetje nga auditimi:

NJZP ka detyrime të papaguara për kredinë në vlerën 2,680,597 euro, përkatësisht në shumën 229,828 euro, për detyrimin e normës së interesit dhe komisionit të angazhimit dhe në shumën 2,450,769 euro, për pagesat e principalit të kredisë, pasi nuk janë përmbushur detyrimet nga zbatimi i marrëveshjes së nënhuasë(*trajtuar më hollësisht në faqen 32, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës, të marrë masa për të siguruar fondet, për të likuiduar Ministrinë e Financës në cilësinë e huamarrësit të kredisë, detyrimet e papaguara në vlerën 2,680,597 euro, të cilat ndikojnë në nivelin e borxhit shtetëror.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi:

Për fondet e pa disbursuara të kredisë, për periudhën 31.12.2008 deri në 6-mujorin e parë të vitit 2015, kanë lindur detyrime për t'u paguar nga NJZP, për detyrimin e tarifës së angazhimit në shumën 120,727 euro, me efekte negative financiare, duke rënduar në mënyrë të padrejtë koston e projektit dhe buxhetin e shtetit, Ministrinë e Financave në rolin e huamarrësit (*trajtuar më hollësisht në faqen 32, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve, të marrë masa për të rillogaritur koston totale të projektit, duke shtuar detyrimet që kanë lindur për pagesat e kredisë që kanë vazhduar përtej afatit të përcaktuar në marrëveshjen e huas, në shumën 120,727 euro, për detyrimin e tarifës së angazhimit për fondet e padisbursuara të kredisë, deri në 6-mujorin e parë 2015.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi:

NJZP për 5 nënprojektet e realizuara, 1(një) nënprojekt është në fazën e zbatimit të punimeve, ndërsa për 4 nënprojekte të përfunduara është realizuar procesi i marrjes në dorëzim dhe administrimit të segmenteve rrugore të përfunduara që nga viti 2007, por kalimi i tyre si asete në Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të punëtorëve të qytetit, nuk është bërë ende, proces ky shumë i vonuar nga strukturat përgjegjëse, veprim në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 27.12.2011, neni 8, pika ç, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, pika 34; i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqen 59, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masa për dorëzimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe financiar të objekteve, që do t'i lihet në përdorim Drejtorisë së Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, si mjete themelore në atë ndërmarrje, në zbatim të ligjit 10296, datë 27.12.2011, neni 8, pika ç, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, pika 34 dhe shkresat nr.11793/3, datë 23.09.2014 dhe nr.11793/2, datë 17.09.2014 të Drejtorisë së shërbimeve mbështetëse dhe drejtorisë së financës së bashkisë Tiranë.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2014 dhe deri në muajin Gusht të vitit 2015 administrimi i karburantit është bërë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, neni 4, paragrafi 22 “Titullar i njësisë publike”, paragrafi 23 “Nëpunës autorizues”, paragrafi 24 “Nëpunës zbatues”, me nenin 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe shkresën e Ministrit të Financave nr. 20606, datë 31.10.2011, pjesa e I, ku përcaktohen përgjegjësitë e titullarit dhe nëpunësit autorizues të njësive publike, të nëpunësit autorizues dhe pjesën e II, ku përcaktohen kompetencat në mënyrë të detajuar të nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve në fushën e MFK (*trajtuar më hollësisht në faqen 37, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Bashkia Tiranë dhe NJZP, të marrë masa për të zhvilluar në kohë procedurat e prokurimit për “Blerje karburant” si dhe përcaktimin e kompetencave të punonjësve për mirë administrimin e karburantit, sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me qëllim shmangien e parregullsive të konstatuara.

Në vazhdimësi

15.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën 2014 - 20 Shtator 2015, krahasuar planifikimin me realizimin e natyrës, sasisë dhe llojeve të kontratave për blerje ose kryerje shërbimesh, që janë prokuruar për këtë periudhë vihet re një programim i fryrë i nevojave për prokurime dhe me vlera më të larta se realizimi, gjë që tregon një parashikim të pa studiuar të fondeve për prokurime, në kundërshtim me nenin 1, pika b të Ligjit “Për Prokurimin Publik” nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9936 , datë 23.03. 2003 “Mbi menaxhimin e sistemit të buxhetit” (*trajtuar më hollësisht në faqen 38, të Raportit Përfundimtar*).

Për sa më lart rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit të marrë masa që në zbatim të nenit 1, pika b të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar” dhe Ligjit Nr. 9936, datë 23.03. 2003 “Mbi menaxhimin e sistemit të buxhetit” të planifikojë dhe argumentojë, fondet për prokurime sipas natyrës, sasisë dhe llojeve të kontratave për blerje ose kryerje shërbimesh.

Në vazhdimësi

16.Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2014, në procedurën e prokurimit “Blerje Artikuj Kancelarie”, KVO dhe komisioni për marrjen në dorëzim të mallit përbëhet nga të njejtët persona, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Gjatë vitit 2014, në procedurën e prokurimit “Blerje Karburanti”, specifikimet teknike të mallit nuk janë firmosur nga grupi i punës dhe tek ofertat e paraqitura dy firma ofertuese kanë të njëjtin administrator, dhe përkatësisht operatori ekonomik “Skënderi G” sh.p.k dhe “Europetrol Durrës Albania” Sh.a, në kundërshtim me VKM nr. 1, Kreu V, pika 2/ a, Ligjin e Prokurimit Publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2015, është parashikuar shërbimi i auditimit të projektit me një vlerë prej 480,000 lekë dhe nuk është realizuar, në kundërshtim me nenin 1, pika b të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar” dhe Ligjit Nr.9936, datë 23.03. 2003 “Mbi menaxhimin e sistemit të buxhetit” (trajtuar më hollësisht në faqen 39, të Raportit Përfundimtar).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë dhe Njësia e Zbatimit të Projekteve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e ligjit shqiptar në rastin e prokurimeve publike, lidhur me krijimin e Njesisë së Prokurimit, Komisionit të Vlerësimit të ofertave, kushteve, afateve dhe dokumentacionit përkatës.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në terren mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të kontrollit të trafikut urban në qendrën e kontrollit (T-UTC) si dhe zbatimin e punim civile për vendosjen e materialeve dhe pajisjeve sipas projektit të zbatimit me specifikimet teknike të miratuara u konstatua se është jashtë funksionit një dera e zakonshme e brendshme (trajtuar më hollësisht në faqen 48 të Raportit Përfundimtar).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë t'i kërkojë shoqërisë zbatuese që brenda periudhës së garancisë të zëvendësohet dera e brendshme në qendrën e kontrollit sipas specifikimeve teknike.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në terren mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të kontrollit të trafikut urban si dhe zbatimin e punimeve civile për vendosjen e materialeve dhe pajisjeve sipas projektit të zbatimit me specifikimet teknike përkatëse të miratuara u konstatua se:

- Në rrugën e Durrësit, sensorët janë jashtë funksioni për shkak të punimeve në rrugë dhe se nuk janë të lidhura me puseta sipas projektit të zbatimit.
- Në disa nyje semaforike, disa shtylla me diametër 102 mm dhe shtylla me krahë nuk janë vendosur sipas projektit të zbatimit.
- Janë dëmtuar butonat e pajisjes dëgjuese për të verbrit.
- Pusetat në nënstacionet “UTC” janë pa kapakë dhe të mbushura me mbeturina.
- Numëruesit(Cowntdownet) nuk janë vendosur në një aks me llambadarët sipas projektit (trajtuar më hollësisht në faqen 49, të Raportit Përfundimtar).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë t'i kërkojë shoqërisë zbatuese që në zbatim të kontratës dhe brenda periudhës së garancisë të bëjë lidhjen dhe vënien në punë të sensorëve, të realizojë vendosjen e shtyllave, të zëvendësohen butonat e pajisjes dëgjuese për të verbrit, të behët pastrimi i pusetave dhe të mbulohen me kapak si dhe të vendosen numëruesit(Cowntdownet) në një aks me llambadarët sipas projektit të zbatimit.

Menjëherë

19.Gjetje nga auditimi:

Shoqëria në zbatim të kontratës së lidhur për garancinë dhe mbikëqyrjen e punimeve ka kryer punën deri në datën 31.08.2014, ndërsa për periudhën në vazhdim nuk ka hartuar raporte mbi mbikëqyrjen e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me objektivin e shoqërisë, ku ndër të tjera shoqëria duhet të sigurojë ndihmën teknike të Menaxhimit të Projektit të Bashkisë Tiranë, për mbikëqyrjen e kontratës së furnizimit dhe instalimit të sistemit T-UTC gjatë tri fazave si: zbatimi i punimeve, vënia në punë dhe periudha e përgjegjësisë ndaj defekteve (trajtuar më hollësisht në faqen 48, të Raportit Përfundimtar).

Për sa më lart rekomandojmë:

a- Bashkia Tiranë dhe NJZP, të analizojnë veprimtarinë e kryer nga konsulenti shoqëria deri në datën 31.08.2014, si dhe të evidentojnë arsyet për moskryerjen e shërbimit për ndihmën teknike të Menaxhimit të Projektit, për mbikëqyrjen e kontratës së furnizimit dhe instalimit të sistemit T-UTC gjatë tri fazave të tij, zbatimi i punimeve, vënia në punë dhe periudha e përgjegjësisë ndaj defekteve, deri më 31.08.2015.

b-Bashkia Tiranë dhe NJZP, t'i kërkojnë shoqërisë që në zbatim të kontratës të sigurojnë ndihmën teknike dhe mbikëqyrjen deri në përfundim të periudhës së garancisë si dhe të hartojë raportet 6- mujore të mbikëqyrjes ndaj defekteve për periudhën deri në përfundim të projektit .

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi:

Në dy raste me vlerë 96, 348 lekë, janë paguar penalitete për mospagesën në afat të detyrimeve për shërbimin e internetit, siç është përcaktuar në kontratën e lidhur me duke paguar padrejtësisht më tepër nga fondet e buxhetit të shtetit (trajtuar më hollësisht në faqen 36, të Raportit Përfundimtar).

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia e Tiranës dhe NJZP, të marrin masa për arkëtimin e vlerës së penaliteteve, për mospagesën në afat të faturave të shërbimit të internetit në vlerën **96,348 lekë**, nga dhe

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Qendra e Kontrollit të Trafikut Urban për Qytetin e Tiranës” u konstatuan diferenca në punime si edhe punime të pa kryera nga shoqëria Vlera e likuiduar e punimeve të pakryera është në shumën **33,249 Euro, e cila përbën ekonomik për Bashkinë Tiranë** (trajtuar më hollësisht në faqen 40, të Raportit Përfundimtar)

Për sa më lart rekomandojmë:

Bashkia Tiranë dhe NJZP, t'i kërkojë shoqërisë duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit shpërblimin e dëmit në vlerën **33,249 euro**, të përfituar padrejtësisht për punime të pakryera për kontratën me objekt “Qendra e Kontrollit të Trafikut Urban për Qytetin e Tiranës”.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e auditimit janë konstatuar përgjegjësi për disa ish punonjës të Njesisë së Zbatimit të Projektit, si:, të cilët kanë qenë të ngarkuar për zbatimin e projektit “Rikonstruksioni dhe zhvillimi i rrugëve lokale dhe sekondare në Bashkinë Tiranë”, për të cilët nuk rekomandojmë masa disiplinore duke i konsideruar të ezauruara, për arsye se nuk janë në marrëdhënie pune me bashkinë e Tiranës, si dhe nuk kanë adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimit të tyre. Ngarkohet Bashkia e Tiranës të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këta persona.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Mimoza Bedini, Skënder Muça, Lavdije Fshazi dhe Jorida Zhegu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj dhe Drejtor i Përgjithshëm Manjola Naço.